



01-245

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-43489/22 dt. 28.02.2022, të pronarëve/investitorëve ”BP-Home Invet” sh.p.k., me përfaqësues Besnik Pllana nga Prishtina, A.S ”Alberti” sh.p.k. dhe ”Luxori Auto” sh.p.k., për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me shtëpi individuale të banimit ”Qershia” me: 32 shtëpi individuale, ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimore Komunal në rr. ”Troja”, ”Rilindasit”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 23.03.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve/investitorëve ”BP-Home Invet” sh.p.k., me përfaqësues Besnik Pllana nga Prishtina, A.S ”Alberti” sh.p.k. dhe ”Luxori Auto” sh.p.k., sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-43489/22 dt. 28.02.2022, përdorimi i ndërtesave shtëpi individuale të banimit ”Qershia” me: 32 shtëpi individuale me etazhitet P+1, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-181120/19 dt. 16.09.2019, në parcelat kadastrale nr. 1820/1, 1820/2, 1820/3, 1820/4, 1820/5, 1820/6, 1820/7, 1820/8, 1820/9, 1820/10, 1820/10, 1820/11, 1820/12, 1820/13, 1820/14, 1820/15, 1820/16, 1820/17, 1820/18, 1820/19, 1820/20, 1820/21, 1820/22, 1820/23, 1820/24, 1820/25, 1820/26, 1820/27, 1820/29, 1820/30, 1820/31, 1820/32, ZK Çagllavica, konkretisht në kuadër Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën ”Troja”, ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18 19 dhe 20, ”Rilindasit”, ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, në Prishtinë, dhe të njejta do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët/investitorëve ”BP-Home Invet” sh.p.k., me përfaqësues Besnik Pllana nga Prishtina, A.S ”Alberti” sh.p.k. dhe ”Luxori Auto” sh.p.k., me kërkesën me 05 Nr. 391/02-43489/22 dt. 28.02.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shtëpi individuale të banimit ”Qershia” me: 32 shtëpi individuale me etazhitet P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimore Komunal në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1820/1, 1820/2, 1820/3, 1820/4, 1820/5, 1820/6, 1820/7, 1820/8, 1820/9, 1820/10, 1820/10, 1820/11, 1820/12, 1820/13, 1820/14, 1820/15, 1820/16, 1820/17, 1820/18, 1820/19, 1820/20, 1820/21, 1820/22, 1820/23, 1820/24, 1820/25, 1820/26, 1820/27, 1820/29, 1820/30, 1820/31, 1820/32, ZK Çagllavica, konkretisht në kuadër Planit

nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 356-203200/20 dt. 02.02.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Burim Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Shpëtim Pllana; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Flakrim Ajeti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Deme Elezaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Vedat Sjaniçaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Valon Bislimi me nr. të licensës 78;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-43489/22 DT. 23.03.2022

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Arber Sadiku
Arber Sadiku



